Ai që mëson një degë të astrologjisë, ka mësuar një degë të magjisë. Sa herë që e shton (mësimin e së parës), e shton (mësimin e së dytës)

Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) tregon se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Ai që mëson një degë të astrologjisë, ka mësuar një degë të magjisë. Sa herë që e shton (mësimin e së parës), e shton (mësimin e së dytës)."

[Sahih] [Transmetojnë Ebu Davudi, Ibn Maxhe dhe Ahmedi]

Profeti në këtë hadith e sqaron se kushdo që mëson dhe merr njohuri rreth astrologjisë dhe argumentohet me lëvizjet, hyrjet e daljet e yjeve për ngjarjet tokësore, siç është vdekja e filanit, jeta ose sëmundja e tij dhe gjërat e tjera që do të ndodhin në të ardhmen, veçse ka mësuar një pjesë të magjisë, ku sa më shumë që njeriu të shtojë nga kjo dituri, aq më shumë e ka mësuar magjinë.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/5989